



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:134629

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06349404

**C.nr.193/23**

**Gjykata Themelore Gjakovë – Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Nehat Qelaj, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Liman Javori në çështjen juridike të paditëses T.V.Ke punësuar në SHFML.”Visar Krasniqi”, në D.Komuna Malishevë, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Fitim Gashi Rr.”Fehmi Agani”, 25/4, Prishtinë, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, jashtë seancës gjyqësore, me datën 25.10.2024 muar këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses T.V.Ke punësuar në SHFML.”Visar Krasniqi”, në D.Komuna Malishevë.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit që në emër të kompensimit të shujtave, t’ia paguaj paditëses **T.V.K** në emër të shujtës ditore të përlloritur për periudhën nga data e vitit 26.06.2021, deri më datë 21.11.2022, gjithsejtë 228 ditë pune t’ia paguaj nga dy euro në ditë, në shumën prej **456.00** euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**III. DETYROHET** e paditura që paditëses t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë shumën prej 104.00 euro, dhe në emër të taksës shumën prej 21.00 euro.

**A r s y e t i m**

Paditësja T.V.Ke punësuar në SH.F.M.L.”Visar Krasniqi”, në D.Komuna Malishevë, përmes të autorizuarit të saj Av. Fitim Gashi Rr.”Fehmi Agani”, 25/4, Prishtinë, në këtë gjykate ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, sipas padisë paditësja është e punësuar në SHFML.”Visar Krasniqi”, në D.Komuna Malishevë, sipas kontratës së punës dhe i cili ka 7 vite përvojë të punës, e cila dëshmohet përmes kontratës së punës, vërtetimit dhe listës së pagës, gjykatës i ka propozuar që të aprovohet padia e paditësit si e bazuar ashtu që paditëset për periudhën

26.06.2021 deri më datë 21.11.2022 ka gjithsejtë 228 ditë pune të përlogaritur sipas shujtës ditore prej 2 euro, t'ia paguaj shumën prej 456.00 euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 21 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi ndër të tjera ka theksuar se Komuna e Malishevës, e konteston vlerën e borgjit lidhur me këtë çështje, pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi pasi që palët të cilët e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruajnë këtë kontratë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjithë kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK me dt: 21.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate, po ashtu, MAPL ka bërë njoftim për kryetaret e Komunave me dt: 22.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate nga MASHT për mungesë të bazës ligjore të kësaj kontrate kolektive, meqenëse kjo kontratë tani nuk është në fuqi, pasi është shkëputur nga MASHT dhe ka qen e lidhur nga kjo ministri komuna e Malishevës - DKAE lidhur me këtë çështje kontestuese nuk kanë legjitimitet te palës aktive në këtë procedurë, por këtë legjitimitet tani e ka MASHT, konsiderojm ne këtë rast kemi të bëjmë edhe më parashkrim duke marr parasysh faktin që kjo padi është ushtruar në gjykatë në vitin 2023, i propozojmë Gjykatës Themelore Gjakovë dega Malishevë që ta refuzon padinë e paditësve si të pa bazuar ose kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës – MASHT.

Me qellim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.717/22 të datës 27.12.2022 dhe kontratën e punës.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndërsa e aprovoj në tërësi për nga lartësia.

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, ndërsa kontestuese rezulton të jetë drejta e kompensimit të mjeteve në emër të shujtave ditore, për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitiv këtij Aktgjykimi, gjë për cilën e paditura e ka pohuar këtë të drejtë të tyre, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas neni 35 par.7 në të cilën përcaktohet se ***“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes***

*restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”,* kjo gjykatë vlerëson se paditësit i takon e drejta e kompensimit për shujtë ditore gjatë punës për ditët e pranisë në punë përkatësisht për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”** ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se **“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”**, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se **“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”**, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shpenzimeve të udhëtimit u vendos që të njëjtën t’u aprovojë sipas periudhës për vitin 2021 - 2022 gjatë të cilës paditësi ka punuar tek e paditura fakt ky që u vërtetua edhe nga vërtetimet e lartcekura, në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurën që paditëses t’ia paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësve, por gjykata pretendimet e të tilla i konsideroi të pa bazuara ngase paditësi padinë e ka parashtruar në periudhën në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, gjegjësisht Kontrata Kolektive e datës 21.01.2021, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësit padinë e kanë parashtruar në të njëjtën periudhë që përkon me kontratën kolektive të vitit 2021, e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se **“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”**, ndërsa pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me legjitimitetin e saj në procedurë, gjykata pretendimet e të tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”**, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”**, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësja sipas padisë kërkonë realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën

ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, ashtu që vendosi që paditësit t'ia njoh shpenzimet e procedurës duke detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguajë shumën prej 104.00 euro në emër të parashtrimit të padisë dhe shumën prej 21.00 euro në emër të taksës gjyqësore.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152 , dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës lidhur me 35.7 e Kontratës Kolektive Arsimit.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.193/23 me datën 25.10.2024**

**Gj y q t a r i**  
**Nehat Qelaj**

**Udhëzim Juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.